



Republika e Kosovës - Republika Kosova	
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica	
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administratë	
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove	
06	Nr./Br. 913/01-10801
Data 18.03.2019	Gjakovë - Djakovica - Gjakova



KOLEGJI "BIZNESI"  
Nr. 95/19 Date 19.02.2019  
PRISHTINË

## Marrëveshje bashkëpunimi

në mes

Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik - Gjakovë  
dhe  
KOLEGJI BIZNESI

për bashkëpunim në funksionalizimin e Këshillit Lokal për Punësim

Këshilli lokal për punësim (KLP) është një organ i krijuar nga Kuvendi Komunal i Gjakovës me qëllim që të ndikojë në orientimin dhe harmonizimin e politikave, programeve dhe shërbimeve mësimore lokale, duke përfshirë praktikën, këshillimin dhe orientimin në karrierë, për të krijuar një ofertë kualitative, e cila do t'i përbushë kërkosat në rritje të tregut lokal dhe rajonal për kuadro të kualifikuar.

Këshilli përbëhet nga përfaqësues të Komunës, Kuvendit Komunal, bizneseve dhe shoqërisë civile. Pjesëmarrja e bizneseve në këtë këshill ka një rëndësi të veçantë që këshilli të funksionojë dhe të luajë rolin e vet në nxitjen e punësimit në Komunën e Gjakovës.

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Gjakovë nënshkruan këtë marrëveshje mirëkuptimi me bizneset për t'u krijuar lehtësira pjesëtarëve të këshillit për pjesëmarrje dhe kontribut në takimet e këshillit.

### Palët janë pajtuar që:

- Do ta ndihmojnë dhe do ta mbështesin njëra tjetrën në mbajtjen e aktiviteteve të planifikuara të KLP për arritjen e qëllimeve për të cilat është themeluar Këshilli në Komunën e Gjakovës.
- Së bashku të krijojnë politika, strategji, plane të veprimit, që do të ndikojnë në punësimin e grupeve të marginalizuara (si: të rinjtë, femrat, komunitetet pakicë, personat me nevoja të veçanta etj.).
- Do të kontribuojnë së bashku në zhvillimin e kuadrove/aftësive adekuate për nevojat e punëdhënësve lokalë dhe regionalë, përmes masave të edukimit dhe trajnimit.
- Do të kontribuojnë për adaptim më të mirë të politikave lokale duke u bazuar në nevojat dhe mundësítë.
- Bashkërisht do të hartojnë planet e punës vjetore të KLP të cilës do t'i përmbahen.
- Bashkërisht do të iniciojnë hartimin e planeve të veprimit dhe strategjive afatgjate për nevojat e tregut të punës.



- Do të angazhohen për integrimin e brengave të shoqërisë civile, komunitetit të biznesit dhe sektorit privat në planifikimet strategjike.
- Marrin pjesë në Këshillin Lokal për Punësim si angazhim vullnetar dhe pa kompensim.

## PËRGJEGJËSITË E PALËVE

### Drejtoria për Zhvillim Ekonomik Gjakovë:

- Ka përgjegjësi që të gjitha dokumentet që përpilon dhe miraton Këshilli lokal për punësim, si strategjitet, planet e aksionit, si dhe rekomandimet dhe sugjerimet për politika të ndryshme zhvillimore, t'i shndërrojë plane pune të Komunës, që do të realizohet përmes ekzekutivit dhe legjislativit lokal në Gjakovë.
- Ka përgjegjësi të përpilojë raporte pune që do t'i paraqesë në mbledhjet e Kuvendit Komunal.
- Do të fasilitojë takimet e grupit lokal të punësimit, do t'i thërrasë takimet dhe do t'i mbajë grupet e interesit të informuara.

### KOLEGJI BIZNESI:

- Do të propozojë një personin adekuat që do të përfaqësoje Kolegjin Biznesi në Këshillin Lokal për Punësim. Personi i propozuar bëhet anëtar i KLP dhe merr pjesë në të gjitha takimet e këshillit në një mandat.
- Pas aprovimit si anëtar i KLP, do të inkurajojë personin e propozuar që të merr pjesë dhe të jep kontribut, duke i krijuar të gjitha lehtësira e duhura për të marrë pjesë në takimet e këshillit.
- Do të komunikojë dhe promovojojë punën e përbashkët të këshillit lokal të punësimit dhe planet zhvillimore, në mënyrë që të ketë sa më shumë biznese të informuara mbi punën e Këshillit lokal për punësim.

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik

Ferdinand Kolaj, drejtor

Vendi dhe Data : 19/02/2019



Vendi dhe Data : 19.02.2019